



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 2474 Prot
20

Tiranë, më 24/01/2013

Lënda : Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, **Gazeta Shqiptare-Redaksia Tiranë.**

VENDIM

Nr. 02, datë 24/01 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të **Gazeta Shqiptare-Redaksia Tiranë.**

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.127, datë 20.07.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është ushtruar inspektim administrativ pranë kontrolluesit, **Gazeta Shqiptare** me objekt:

- Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale sipas Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.9, datë 15.09.2009 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive" në lidhje me publikimet online që kanë lidhje me subjektin e të dhënave personale, z. i

Shtetasi A. K ka paraqitur ankesë pranë Zyrës së Komisionerit në lidhje me artikullin "Përgjimet ambjentale zbardhin korrupsionin në Universitete" të publikuar nga Gazeta Shqiptare në faqen e vet zyrtare www.balkanweb.com. Ankesa konsiston në mbajtjen aktive (online) të këtij artikulli ku shtetasi i sipërcituar përmendet si kallëzues me identitet të plotë.

Artikulli me lidhjen përkatëse:

"<http://www.balkanweb.com/gazetav5/newsadmin/preview.php?id=78748>"

mban datën e publikimit 19.05.2010 dhe rezulton aktiv në arkivën elektronike të Gazetës Shqiptare.

Në këtë artikull z. përmendet si kallëzues pranë organeve të policisë gjyqësore në lidhje me veprime korruptive që kryen në Universitetin Bujqësor të Kamzës.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, i nënshkruar rregullisht nga palët, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara në dosje doli për **Gazeta Shqiptare, me Urdhërin Nr. 06, datë 20.11.2012 sipas të cilit ky kontrollues detyrohej që:**

-Në zbatim të nenit 5, nenit 30 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.9, datë 15.09.2009 "Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive", "**Gazeta Shqiptare**" duhet të bënte fshirjen ose anonimizimin e të dhënave identifikuese të shtetasit . **në të gjitha artikujt ku ai rezulton si kallëzues në lidhje me ngjarjen e trajtuar.**

- Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm ligjor duhet të kryhej nga kontrolluesi brenda një afati kohor prej 5 (pesë) ditësh.

Komisioneri pasi bëri verifikimet e duhura në lidhje me zbatimin e Urdhërit Nr. 06, datë 20.11.2012 konstaton se nga kontrolluesi nuk është përmbushur detyrimi ligjor i kërkuar ligjërisht me qëllim respektimin e të dhënave personale të shtetasit

Bashkangjitur këtij vendimi, në cilësinë e provës materiale për mosrespektimin e Urdhërit të sipërcituar të Komisioneres gjendet edhe kopja e artikullit (print online i datës 24.01.2013), nga ku rezulton se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij Urdhëri.

Në këtë rast mospërmbushjeje të detyrimeve të parashikuara nga Urdhëri, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

- Moszbatimi i Urdhërit Nr. 06, datë 20.11.2012 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e ngarkon kontrolluesin me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1, gërma "a", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Komisioneri ka parasysh shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 5-9, 39/1; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", 107-109 të K.Pr.Administrative, si dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative":

V E N D O S A

1. Dënimin e Kontrolluesit, **Gazeta Shqiptare**, Tiranë, me gjobë, si më poshtë:

1/a. Bazuar në nenin 39 pika 1, gërma "a", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale, me vlerën 300.000 (treqind mijë) lek;

2. Të përmbushet, detyrimi ligjor që buron nga Urdhëri Nr. 06, datë 20.11.2012 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe konkretisht **kontrolluesi, Gazeta Shqiptare duhet të bëjë fshirjen ose anonimizimin e të dhënave identifikuese të shtetasit në të gjitha artikujt ku ai rezulton si kallëzues në lidhje me ngjarjen e trajtuar në Urdhërin e sipërcituar.**
3. Detyrimet që rrjedhin nga ky vendim të përmbushen brenda një afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
4. Gjoha, arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi;
5. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit;
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot me datë, 24.01.2013.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (Pogaçe)

